

## **Konsultimet nacionale me përfaqësuesit e rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së**

21. shkurt 2011  
Graçanicë, Kosovë

Konsultimet nacionale me përfaqësuesit e rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës (RRVSK) mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së i ka organizuar Qendra për hulumtim, dokumentim dhe publikim (QHDP), në Graçanicë, Kosovë, me 21. shkurt 2011. Takimin e moderoi Nora Ahmetaj (QHDP dhe Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, Kosovë), ndërsa fjalën hyrëse e mbajtën Bekim Balaj (FDH, Kosovë), Sonja Radošević (Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, Mali i Zi), Snežana Zdravković dhe Marinko Đurić (Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në KiM, Serbi).

Në Konsultimet Nacionale morën pjesë 41 pjesëmarrës, prej të cilëve 18 përfaqësues të Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, 10 vëzhgues, 2 media, 5 panelistë dhe 6 organizatorë dhe anëtarë të Koalicionit për KOMRA-në.

Konsultimet nuk u përcollën nga mediet shqiptare, por kanë qenë të përcjellura nga mediet serbe, radio KiM dhe Media Centar nga Çagllavica.

Diskutimi ka qenë dinamik, dhe i fokusuar. Pjesëmarrësit kanë qenë të udhëzuar dhe të informuar në lidhje me Draftin e Statutit të KOMRA-së, pavarësisht nga ajo se deri tani nuk kanë qenë të përfshirë në proces. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë shumë aktiv gjatë debateve. Ka qenë interesimi i madh i pjesëmarrësve të konsultimeve për bashkëngjitje në Iniciativën për KOMRA-në, ndërsa gjashtë pjesëmarrës kanë nënshkruar formularin e aplikimit në Koalicionin për KOMRA-në.

### **Propozimet, opinionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/eve:**

**Përkrahja ime për KOMRA-në është si individuale poashtu edhe kolektive sepse Shoqata e familjeve të viktimave, anëtare e së cilës jam edhe unë, ia ka dhënë përkrahjen e saj Koalicionit për KOMRA-në.**

*E kemi parë se para se gjithash është interesi i ynë në te, në atë Koalicion, dhe mund të them se është interes edhe i Koalicionit por edhe i yni, vërtetimi i fakteve për krimet e luftës, para se gjithash vërtetimi i të vërtetës për të gjitha viktimat. (Snežana Zdravković, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë dhe Metohi, Prikuplje, Serbi, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

### **Kundërshtarët e idesë për KOMRA-në i frikësohen të vërtetës.**

*Shoqata iu ka bashkëngjitur këtij Koalicioni, jemi përcaktuar për mbështetjen; secili i ka pasë motivet e veta ndërsa motivi im më i madh, në fakt, është ndjenja që viktimat të mos trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjitha këto hapësira, dhe kjo ka qenë arsyeja që ne si viktimat, gjegjësisht familjet t'i paraqesim disa prej argumenteve tona dhe të mund të marrim pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e vërtetimit të fakteve... Më duket se kundërshtarët e një iniciative dhe ideje të tillë në të shumtën e rasteve mund të jenë ata të cilët i frikësohen të vërtetës. Ne nuk kemi arsye, posaçërisht familjet dhe viktimat tona, të turpërohem nga ajo se kanë vdekur në pragun e shtëpisë së tyre dhe se ato fakte të mos vërtetohen dhe të zbulohen. (Marinko Đurić, Shoqata e të vrarëve dhe të kidnapuarve në Kosovë dhe Metohi, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

### **Komisioni duhet të merret me vërtetimin e përgjegjësive politike dhe komanduese.**

*Vërtetimi i të vërtetës, në fakt në Kosovë nënkupton vërtetimin e përgjegjësive politike dhe komanduese. Mua më vjen mirë që në Serbinë qendrore ekzistojnë persona të cilët janë proceduar në nivele të ndryshme nga organet e strukturave policore, ushtarake dhe politike të Republikës së Serbisë, për krimet e kryera në Kosovë në periudhën e viteve 1998 dhe 1999, por nga ana tjetër më pengon shumë që asnjëri nga këta persona nuk është përgjegjës dhe as nuk është shpallë përgjegjës në asnjë mënyrë, as ligjore, apo as në mënyrë morale-etike apo në çfarëdo mënyre tjetër, për krimet e kryera ndaj popullatës jo-shqiptare apo ndaj popullatës serbe në Kosovë në periudhën e viteve prej 1998. deri 1999, dhe 2000. Pra, nuk janë vërtetuar... Mendoj se, përveç tjerash, komisioni do të duhej të merrej me vërtetimin e përgjegjësive politike dhe komanduese. (Nenad Maksimović, Qendra për paqe dhe tolerancë, Graçanicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

### **Nuk është e mundur të vërtetohen rrethanat politike dhe shoqërore të cilat kanë sjellë deri te shpërthimi i luftës.**

*Neni 13, "Komisioni i ka këto qëllime", nën a)... Nuk jam i sigurtë se, pse janë marrë parasysh rrethanat politike dhe shoqërore? Mendoj se kjo, madje edhe për një grup ekspertësh, sot do të ishte e pamundur të vërtetohet rrethanat politike dhe shoqërore të cilat kanë sjellë deri të ndonjë krim i luftës apo shkelje të çfarëdo të drejte të njeri... Nëse do ta merrnim parasysh Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroacinë dhe Serbinë, cilindo shtet nga rajoni, do të shohim se secili e ka mendimin e vet për rrethanat politike dhe ato shoqërore, andaj, tani është shumë herët, po e them se, madje edhe për ndonjë grup të ekspertëve ndërkombëtarë dhe neutral nuk do të mund*

*të tregojnë në rrethanat politike apo shoqërore, dhe nëse do të angazhoheshin për një qëndrim i cili do të dallonte nga të gjitha qëndrimet tjera, sepse secili e ka qëndrimin e vet për [rrethanat] politike dhe shoqërore... Ky është një term me kuptim shumë të gjerë, siç është term i gjerë kur është shkatërruar Jugosllavia, kur ka ardhë deri të shpërbërja e saj. (Saša Ilić, Rrjeti strategjik i veprimit të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

#### **Të zgjerohet mandati i KOMRA-së deri në vitin 2004.**

*Kërkesa që viti 2004 të përfshihet në mandat, është plotësisht e arsyetueshme...kjo hynë në kategorinë e shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut, e cila nuk e përjashton që të hetohet edhe ajo periudhë. (Marinko Đurić, Shoqata e të vrarëve dhe të kidnapuarve në Kosovë dhe Metohi, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

*Neve po na pengon ajo data 2001, sepse edhe më tutje po shkelen të drejtat e njeriut. Mendoj, se akoma familjet janë të ndara [familjet serbe], akoma nuk po mund të kthehen këtu, nuk po mund ta shfrytëzojnë pronën e tyre, akoma po ndjehet pasiguria, nuk ka liri të lëvizjes. (Gordana Đorić, Rrjeti strategjik i veprimit të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

#### **Përkrahja e idesë për themelimin e KOMRA-së, dhe qëndrimi pas saj, është akt civilizues.**

*Ne i përcjellim aktivitetet e KOMRA-së me vite, dhe na vjen shumë mirë që tashmë e kemi filluar këtë temë edhe në këto treva këtu, dhe natyrisht e vlerësoj si një akt civilizues përkrahjen e kësaj ideje. Thënë sinqerisht, unë edhe tashmë dyshoj se pas tri vitesh do të mund të arrijmë të kemi efekte të mëdha, duke e ditur situatën dhe duke e parë këtë mosbesim i cili po ndihet në këtë diskutim këtu mes neve, dhe se do të arrijmë ndonjë progres. (Žarko Joksimović, gazetarë nga Link Produksioni, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

#### **Reciprociteti në zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA-së në bazë të përkatësisë etnike, është shumë i rëndësishëm.**

*Mua më intereson reciprociteti, mendoj se është shumë i rëndësishëm, ju keni thënë tre anëtarë [KOMRA], prej të cilëve njëri është femër. Është shumë e rëndësishme që këtu të jetë një reciprocitet, unë mendoj se katër anëtarë do të ishte numër ideal për te, dhe të jenë të përfshira të gjitha nacionalitetet, kështu do të fitohej kredibiliteti. (Jelena Miličević, Misioni i njerëzve të vullnetit të mirë, Mitrovicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

*(...) Dy shqiptarë dhe një serbë, sipas meje është me të vërtetë...duhet të jetë edhe një serb. Duhet të ekzistojë ai reciprociteti. (Snežana Perić, Qendra për promovimin e të drejtave të të rinjve, Novo Bërdë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

### **Presidenti nuk do të duhej ta bëjë përzgjedhjen përfundimtare të anëtarëve të KOMRA-së.**

*Kur keni thënë se presidenti vendosë për anëtarët. Kjo për mua është e papranueshme. Sepse, me këtë çështje do të duhej të merren organizatat joqeveritare, do të duhej të merren individët, mendoj shoqatat, asociacionet dhe ata do të duhej t'i zgjedhin përfaqësuesit, e të mos vendosë për këtë presidenti i shtetit (...) në Kosovë, posaçërisht, në të gjitha ato, të them forumet politike, kanë mbetur ata të cilët kanë marrë pjesë në luftë. Dhe sigurisht se ai më parë do të propozojë ndonjë anëtarë i cili nuk do të angazhohej t'i shoh krimet e tij, por do të mendohej ti sheh krimet e të tjerëve. (Gordana Đorić, Rrjeti strategjik i veprimit të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

*(Thjesht është e pabesueshme për mua, që me statut t'i ofrohet aq mundësi e madhe qeverisë dhe qeverive për t'a kontrolluar punën dhe për të kontrolluar përzgjedhjen e anëtarëve... në Kosovë akoma, edhe më tutje, në qeveri është regjimi i njëjtë, i cili në një mënyrë është përgjegjës për krimet të cilat janë kryer, dhe thjeshtë e kam të pabesueshme që me statut ne vetë vetes po ia lidhim duart, dhe vetë vetes po ia kufizojmë lirinë. Nëse ky ka qenë, apo nëse ky është një koncesion i dhimbshëm i cili duhet të bëhet për tu arritur mbështetja politike, e kuptoj, nëse kjo është kështu, dhe besoj se do të duhej të më thoni se kjo është dashur të bëhet kështu, nëse jo, thjesht e kam të pabesueshme që vetë vetes ia kemi kufizuar lirinë. (Nenad Maksimović, Qendra për paqe dhe tolerancë, Graçanicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

### **Serbët nga Veriu i Kosovës duhet të përfshihen në procesin e KOMRA-së.**

*Unë, absolutisht e mbështesë këtë iniciativë, më të vërtetë më tërë zemrën time, dhe ajo që desha të them dhe fuqishëm ta theksoj, nëse ju mendoni ta përfshini veriun në iniciativë, këtu do të duhet të jeni shumë, tejet objektiv, si nga njëra anë, poashtu edhe nga tjetra. Nëse mendoni të veproni në veriun e Kosovës, a e dini ju, se kampanja juaj duhet të jetë objektive dhe paanshme... (Snežana Perić, Qendra për promovimin e të drejtave të të rinjve, Novo Bërdë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*

**Nuk ka sukses në shoqëri dhe askush nuk mund të shkojë më tutje, derisa nuk do të jepen llogaritë për atë se çfarë ka ndodhur.**

*Nuk mund të bëhet pa ju, nuk mundet pa viktimat, nuk mundet pa ata të cilët më së shumti kanë pësuar që të vihet deri te pajtimi. Dhe në këtë aspekt mendoj se se kjo është mundësia që të vihet jo vetëm deri te e vërteta e cila është shumë e rëndësishme, por është mundësia që të hapen proceset e reja. Ato do të jenë të vështira, nuk do të besohet në to, pastaj do të besohet, por më e rëndësishmja është që ata të cilët kanë vuajtur më së shumti, të cilët janë viktima, ata pranojnë të flasin dhe kjo për mua është pasuria më e madhe.*

*Nëse kjo iniciativë, siç po synohet këtu, të ngritet në nivelin më të lartë dhe të institucionalizohet, mu kështu siç është paraparë me statut, dhe unë jam jurist i diplomuar, andaj këtë çështje e kuptoj mjaft mirë si dhe të gjithë ato propozime, mendoj se do të jetë mundësi për të gjithë popujt të cilët jetojnë në këtë rajon. Andaj, dëshiroj tua japë tërë mbështetjen time dhe u uroj që të keni sukses. Sigurisht do të keni sukses, sigurisht do të arrini suksesin sepse nuk ka sukses në shoqëri dhe askush nuk mund të shkojë më tutje, përderisa nuk do të jepen llogaritë për atë se çfarë ka ndodhur. (Momčilo Trajković, Çagllavicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me përfaqësuesit e Rrjetit të veprimit strategjik të Kosovës, Graçanicë, Kosovë, 21. shkurt 2011).*